



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË
Komiteti për Politikë e Financa
I.Numër: 060/01-109406
Pejë, datë: 17 Tetor 2022



PROCESVERBAL

Nga takimi i IX i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me 17 tetor 2022, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e komitetit për politikë dhe financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, z. Arianit Krasniqi, Drejtor i Çështjeve Pronore Juridike, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, znj. Donjeta Morina zyrtare Administrative, z. Egzon Kastrati Asistent Administrativ i kryesuesit, dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditës .

Unanimisht nga të gjithë të praniashmit u miratua ky:

Rendi i Ditës

- (1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
- (2) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve: Procesverbali i KPF-së dt.19.07.2022 dhe Procesverbali i KPF-së 16.09.2022
- (3) Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronë pronarit fizik z. Bajram Idriz Sahatçiu dhe te tjerët, me qëllim të formimit të rruge në Majen e Zezë sipas Planit Zhvillimor Komunal në Pejë, si interes publik ne Pejë.
- (4) Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit fizik znj. Zelka Pavata me qëllim të formimit të rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- (5) Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit fizim z. Hasan Zelkqi dhe te tjerët, me qellim te formimit te rrugës shtegun e ecjes buzë “Lumbardh” sipas Planit Zhvillimor Komunalë.
- (6) Informatë për gjendjen ekonomike- financiare ne Komunën e Pejës.
- (7) Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik-Shtator 2022.
- (8) Informatë nga drejtori i NPL Ambienti për gjendjen e grumbullimit të mbeturinave në Komunën e Pejës.
- (9) Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë renditje siç janë pranuar:

I. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur

II. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve: Procesverbali i KPF-së dt.19.07.2022 dhe Procesverbali i KPF-së 16.09.2022.

Unanimisht miratohet Procesverbali i KPF-së i dates 19.07.2022 dhe Procesverbali i KPF-së 16.09.2022, me vërejtjet qe u dhanë.

III. Shqyrtimi i propozimit të DCPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit fizik z. Bajram Idriz Sahatçiu dhe te tjerët, me qëllim të formimit të rrugës në Majen e Zezë sipas Planit Zhvillimor Komunal në Pejë, si interes publik ne Pejë.

z. Arianit Krasniqi: Është propozim vendimi mbi miratimin e Kryetarit për këmbimin e pronës së paluajtshme të pronarit fizik z. Bajram Sahatçiu dhe të tjeret, me qëllim të realizimit të rruges tek Maja e Zeze, është një këmbim me të cilën rruga është realizua neve na mbetet vetëm me i përgatit procedurat tjera të cilat na duhet mi nënshkru për realizimin dhe regjistrimin e këtyre parcelave si rrugë. Materialin e kemi dorëzu me kohë bëhet fjalë për një rrugë që përbëhet prej 5 parcelave me sipërfaqe 20 ari qe propozohet me u këmbye me një parcele e cila është komunale me nr.470/0 me sipërfaqe prej 72 ari, është parcele e Komunës e cila rrethohet me parcelat e pronarëve privat të familjes Sahatçia e cila nuk ka rrugë dhe neve na mundëson me bo rrugë. Kur ju te jeni të gatshëm mundem me dal në terren me vizitu.

znj.Xhevahire Ceku Kelmendi: Drejtor nëse ka mundsi me na tregu se në cilin vend kena me jep parcelën në këmbim?

z. Arianit Krasniqi: Është një parcelë tek Maja e Zezë e cila nuk ka rrugë, nuk kemi qasje ne si Komunë, është e krijuar vite më herët e cila përreth rrethohet me parcela të pronarëve me te cilët ne e kemi bënë propozimin për këmbim. Pastaj varësisht prej vlerësimit qe del prej komisionit i cili është i caktuar Komision Qeveritar që e bënë vlerësimin në gjithë Kosovën.

z. Berat Ganiq: Këmbimi qe po bëhet po i bijën me i marr 20 ari e me i këmbye 70 ari po i bijën 51 ari e 32m2 diference shumë e madhe qe po i falet pronarit, nuk është zgjidhje kish me qenë mirë nëse ish ndërru ari për ari meqenëse është vendi i njëjt, nëse kish qenë te Lumëbardhi shëtitörja nuk e kisha pengu mirëpo këtu tek Maja e Zezë po me duket e pa arsyeshme.

z. Labinot Panxha: Meqenëse po na vjen çdoherë materiali i mangët dhe jo në përputhje me ligjin po na bënë me dyshu qe po keqpërdoret toka e Komunës, dhe këtu nuk e keni fajin as ju dhe as Kryetari i Komunes por te anëtarët e Kuvendit te asambleja pasi qe e shohin qe është materiali i mangët dhe e votojnë për me kalu, dhe ne si Aleancë jemi kundër këtyre këmbimeve.

z.Kryesusi Rexhep Kurbogaj: Në përshtypje të pare duket e pa krahasueshme ama unë mendoj qe duhet me pas parasysh se prona në çfarë pozite është a afër rrugës kryesore apo ne zonë me të thellë.

z. Mentor Bajri: Është mirë që me dal në terren, me pa të gjithë dhe me vlerësu se çka është në interes publik e diskutojmë te gjithë së bashku dhe e zgjedhim problemin.

z. Berat Ganiqi: Nëse nuk ka qasje ne rrugë, çasja në rrugë krijohet nuk mundesh me lën parcele pa rrugë; krijohet e drejta e servitutit rrugor.

z. Arianit Krasniqi: Vlera e zonës në parcelën ku gjendet prona e Komunës me vlerën e parcelës buzë rrugës është ndryshe, vlerësimi prej komisionit për atë zonë është për ari 1100 euro, ne i kemi të dokumentuara me letra e kemi vlerësimin, kush do qe nuk pajtohet është e drejta e juaja.

Nga anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me 5 anëtar pro, 4 anëtar kundër.

IV. Shqyrtimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën pronarit fizik znj. Zelka Pavata me qëllim të formimit të rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal.

z. Arianit Krasniqi: E kemi një propozim për këmbim prone në mes te Komunes së Pejës dhe pronarit fizik znj. Zelka Pavata bëhet fjalë për parcelën me nr.3113-0 me sipërfaqe 86m², për qëllim të zgjerimit të rrugës, propozohet të këmbehet me pronën me nr.3365/14 me sipërfaqe 142m² dhe nr. 3437/2 me sipërfaqe 6 m² qe gjendet te shkolla Vaso Pash Shkodrani, ku llogaritet edhe shpronësimi, investimi i një shtëpie qe gjendet aty.

znj. Kaltrina Lajçi: A ekziston një mënyre tjetër qe pronari me kërku një këmbim tjetër , jo pronë me pronë po me para kesh?

z. Arianit Krasniqi: Nuk kemi fonde të mjaftueshme për të bër një realizim të tillë.

z. Labinot Panxha: Kush bindet prej neve qe këto 86m² duhet me patjetër me u marr për me u zgjeru rruga, unë mendoj qe ky këmbim i shkon përshtati një interesi të caktuar të një individi.

z. Berat Ganiqi: Me ligj është e përcaktumë se nëse behet këmbimi i pronës ngastra qe këmbehet duhet me qene në kufizim me ngastrën e pronarit qe po këmbehet.

Nga anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me 5 anëtar pro, 4 anëtar kundër, te përmbajtur nuk ka.

V. Shqyrtimi I propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën pronarit fizim z. Hasan Zelkqi dhe te tjerët, me qellim te formimit te rrugës shtegun e ecjes buzë “Lumbardh” sipas Planit Zhvillimor Komunalë.

z. Arianit Krasniqi: Kemi një propozim vendim këmbimi i pronës mes Komunës së Pejës dhe pronarit privat familjes Zelkqi, bëhet fjalë për një parcele me nr. 1835/14 me sipërfaqe 996m² ku është prone Komunale e ne te cilën e kanë ndërtu shtëpinë viteve më herët familja Zelkqi, propozohet për këmbim me pronën ne ngastrën e njëjtë me nr.1835/14 me sipërfaqe te njëjtë, me qellim të krijimit të shëtitores buze Lumbardhit përball patrikanës, krijohet shtegu i ecjes qe lidhet me shtegun e shëndetit.

Pas diskutimeve unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit per shqyrtim dhe miratim.

VI. Informata për gjendjen ekonomike- financiare ne Komunën e Pejës.

Kryesuesi Rexhep Kurbogaj: Në mungesë te drejtorit të financave i cili nuk ka pas mundësi sot me qenë prezent na ka informu, është fjale për gjendjen ekonomike financiare për Komunën e Pejës.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët me 6 vota pro, 3 vota te përmbajtur, kundër nuk ka te përmbajtur nuk ka prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim

VII. Shqyrtimi I raportit financiar të Komunës së Pejës për periudhën Korrik-Shtator 2022.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent me 7 vota pro, 2 të përmbajtur, kundër nuk ka, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

VIII. Informatë nga drejtori i NPL Ambienti për gjendjen e grumbullimit të mbeturinave në Komunën e Pejës

Kryesuesi Rexhep Kurbogaj: Materialin për këtë raport informative e keni marrë paraprakisht na kanë informu që drejtori nuk mundet me qen prezent, mirëpo në Kuvend duhet të jetë prezent përfaqësuesi i Kompanisë.


Pas diskutimeve unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

IX. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë Renditje siç janë pranuar:

Nuk ka pasur.

Pjesë e këtij procesverballi është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:00 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina




KRYESUESI,
z. Rexhep Kurtbogaj
